




**OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
TIRANE**

**Raport – Studimor
“Situata e fëmijëve romë dhe egjiptian” për vitin 2012 - Qarku – Tiranë**



QARKU – TIRANË
Eksperte – Rajonale
Arsa Agalliu

Lista e Shkurtimeve:

- Observatori** - Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Tirane
- ACA** - Aleanca për Fëmijët në Shqipëri
- UNICEF** - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
- NJDF** - Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
- NJMF** - Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
- MASH** - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- DAR** - Drejtoria Arsimore Rajonale
- ZA** - Zyra Arsimore
- DSHPSH** - Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore - Qarku – Tirane
- MB** - Ministria e Brendshme
- PAK** - Personat me Aftësi të Kufizuara
- OBSH** - Organizata Botërore e Shëndetësisë

I. Parathënie dhe falenderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një iniciativë e UNICEF, që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Zyra e observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm. Në rajonin e Tiranës, observatori ushtron veprimtarinë e tij që në janar të vitit 2011.

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” - Tirane ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh publikë dhe jopublikë. Observatori - Tirane ka ngritur rrugën e bashkëpunimit me 57 aktorë të rëndësishëm, si: prefektura, qarku, bashkitë dhe komunat, institucionet - shëndetësore, arsimore, të shërbimeve – sociale, të policisë dhe të punësimit.

Arritjet në nivel lokal për vitin 2013 konsistojnë në kontributin e observatorit - Tirane në realizimin e faqes se web (www.observator.org.al).

Gjithashtu përmes raporteve të observatorit është bërë e mundur jo vetëm paraqitja e situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve në qarkun – Tiranë, por edhe lobimi dhe advokimi në rrjetin e organizatave të shoqërisë civile, NJDF-së në nivel Qarku si dhe NJMF-së në nivel Bashkie. I gjithë ky proces ka konsistuar në sensibilizimin e gjithë aktorëve përgjegjës për më shumë vëmendje ndaj të drejtave të fëmijëve e krijimin e mekanizmave mbrojtës për fëmijët edhe në nivel të komunave të qarkut - Tiranë.

Përveç mbledhjes së treguesve të të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, punësim, ndihmë - ekonomike, observatori ndërmoi nismën e realizimit të një studimi - rajonal lidhur me temën “Situata e fëmijëve romë dhe egjiptian ” për vitin 2012 - Qarku – Tiranë.

II - Hyrja

Historik i përgjithshëm mbi qarkun e Tiranës

Qarku Tiranë i cili është qarku ku përqëndrohet numri më i madh i popullsisë në vend, ka një popullsi me 1,013,561 banorë nga të cilët 256,119 janë fëmijë të moshës 0-18 vjec. Popullsia romë në Qarkun e Tiranës përbëhet nga 3238 banorë bazuar në regjistrimin e fundit në vitin 2011.

Mungesa e të dhënave rreth realizimit të drejtave të fëmijëve romë/egjiptianë mund të sjellë pengesa në planifikimin, financimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve për përmisimin e situatës së drejtave të këtij komuniteti qoftë nga ana e shtetit ashtu edhe nga ana e shoqërisë civile.

Fëmijët , për shkak të moshës së tyre , papjekurisë mendore dhe fizike , janë grupi i cili është i ekspozuar shumë ndaj rrezikut , dhe për këtë arsye ata kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë nga familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore të tyre. Përmirësimi i legjisllacionit për mbrojtjen e fëmijëve ka qenë prioritet i të gjitha qeverive pas '90 në Shqipëri . Ky prioritet është mbështetur gjithmonë nga lëvizjet e advokatorëve të të drejtave të fëmijëve, të nxitura nga

institucionet ndërkombëtare si UNICEF-it dhe rrjeteve të tjera të OJF-ve . Edhe pse duhet theksuar se ka boshllëqe dhe probleme midis legjislacionit të shkruar dhe zbatimit të tij, legjislacioni garanton të drejta të barabarta për individët në nevojë dhe qytetarët e tjerë, pavarësisht nga shkaqet , natyra dhe shtrirja e shfaqjes së nevojës .

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij raporti është përshkrimi i situatës së realizimit të drejtave të komunitetit romë/egjiptianë; analiza e situatës e të drejtave nisur kjo nga aksesit/ mundësia që kanë anëtarët e këtyre komuniteteve për të përfituar fillimisht nga shërbimet sociale.

Çështjet që ky raport ka marr në shqyrtim janë:

- ✓ Cilat janë nevojat e komunitetit romë/egjiptianë ?
- ✓ Cili është niveli i arsimimit të fëmijëve romë/egjiptianë?
- ✓ Cili është niveli i braktisjes së shkollës tek fëmijët romë/egjiptianë?
- ✓ Kush janë disa nga shkaqet që pengojnë arsimimin e këtyre fëmijëve?
- ✓ Cilat janë barrierat kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimin cilësor të fëmijëve romë/egjiptianë?
- ✓ Sa është masa e përfitimit të anëtarëve të këtij komuniteti në të drejtën për përkujdes shëndetësor?
- ✓ A ndihen të diskriminuar anëtarët e komunitetit romë/egjiptianë ?
- ✓ Kush është shkalla e përfshirjes së anëtarëve të këtij komuniteti ?
- ✓ Në çfarë mase është përfshirja e këtij komuniteti në shërbime sociale ?
- ✓ Kush janë nevojat e shprehura nga vetë komuniteti por edhe nga aktorë të tjerë publik apo të shoqërisë civile për një integrim të këtij komuniteti ?
- ✓ Cilat janë efektet e politikave ekzistuese në lidhje me arsimimin e fëmijëve romë/egjiptianë por edhe të në lidhje me përfshirjen në kujdes shëndetësor; mbrojtje sociale e pjesëmarrje?

Ky raport ofron një panoramë të situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë në qarkun Tiranë bazuar në 4 fushat kryesore: kujdes shëndetësor; edukim; mbrojtje sociale dhe pjesëmarrje.

Gjithashtu ky raport studimi mund tu shërbejë njësive të qeverisjes vendore, bashkive/ komunave përkatëse ku ka vendndodhje të komunitetit romë dhe egjiptianë me qëllimin për të përmirësuar kushtet dhe standardet e jetesës së fëmijëve romë dhe egjiptianë. Gjithashtu, ky studim mund t'ju shërbejë institucioneve rajonale, organizatave të shoqërisë civile dhe personave të tjerë të interesuar për të përmirësuar situatën e të drejtave të fëmijëve romë dhe egjiptianë , - duke synuar integrimin e plotë të këtyre fëmijëve në jetën sociale.

Raporti ofron një përshkrim të situatës apo gjendjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në Qarkun - Tiranë. Por ky raport studimor pritet që të ngjallë kureshtjen e interesin e profesionistëve të qeverisjes vendore, profesionistëve në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale për të

kuptuar më mirë e në thellësi gjendjen e fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë në qarkun Tiranë.

Gjithashtu raporti në fjalë mund ti ndihmojë ato në ndërhyrjet në të ardhmen, në mënyrë që të plotësojnë më së miri nevojat e fëmijëve të komuniteteve romë e egjiptiane si dhe adreson në hartimin e politikave më favorizuese për këtë kategori të marginalizuar.

Tabela 1. Numri i fëmijëve që jetojnë në risk dhe situatë rreziku

Burimi : Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (Qershor - 2013), MOLSAO

Tabela 1

Nr	Rajoni	Nr. i fëmijëve që jetojnë në risk dhe situatë rreziku - viti -2012
1	Tirane	130

Ø Vetëm në 2012 janë hapur 293 raste të fëmijëve që jetojnë në risk dhe situatë rreziku:

Tabela 2

Nr	Rajoni	Nr i rasteve të reja të fëmijëve që jetojnë në risk dhe situatë rreziku, - identifikuar gjatë vitit 2012
1	Tirane	79

Tabela 2. Numri i rasteve të reja të fëmijëve që jetojnë në risk dhe situatë rreziku, - identifikuar gjatë vitit 2012

Burimi : Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (Qershor - 2013), MOLSAO

Ndërkohë në qershor 2013, shoqata “ ARSIS “ për mbështetje sociale të rinisë ka kryer studimin "Analiza e fëmijëve në situatë rruge në nivel kombëtar". Studimi synonte për të kuptuar përmasat e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri. Në përputhje me këtë studim, në fazën e parë: 1. që e konsideronte fëmijët në situatë rruge, në 8 rajone të Shqipërisë dhe 2. në fazën e dytë që e konsideronte fëmijët në situatë rruge, në të gjitha rajonet e vendit (12 rajone).

Rezultatet për numrin e fëmijëve në situatë rruge të mbledhura nga faza e parë e studimit janë si më poshtë:

Tabela 3

Nr	Rajon	Nr i femijeve ne situatë rruge – Gusht, 2013
1	Tiranë	636

Tabela 3. Numri i fëmijëve në situatë rruge - identifikuar në gusht 2013

Burimi: “ ARSIS ” - Shoqata për mbështetje sociale të rinisë, - "Analiza e fëmijëve në situatë rruge, në nivel kombëtar - Faza e parë "

Në fazën e dytë është llogaritur numri i fëmijëve ne rruge rritur ose krahasuar me fazën e parë .
Të dhënat për fazën e dytë janë paraqitur në Tabelën Nr . 4 :

Tabela 4

Nr	Rajon	Nr i femijeve ne situatë rruge – Tetor, 2013
1	Tirana	509

Tabela 4: Numri i fëmijëve në situatë rruge - identifikuar në tetor 2013

Burimi: “ ARSIS ” - Shoqata për mbështetje sociale të rinisë, - "Analiza e fëmijëve në situatë rruge, në nivel kombëtar - Faza e dytë “

Profili i komunitetit romë dhe egjiptianë

Minoriteti rom në Shqipëri jeton së bashku me minoritetet e tjera dhe konsiderohet si një minoritet gjuhësor. Ata mund të quhen të përjashtuar në shoqërinë Shqipëtare, kjo si pasoje e paragjytimeve, mënyrës së jetesës që bëjnë, nivelit të ulët arsimor dhe intelektual i cili është problemi më i madh i këtij komuniteti që i ka izoluar akoma më shumë nga shoqëria. De fakto kemi shumë pak studentë nga komuniteti rom.

Komuniteti (minoriteti) romë dhe komuniteti egjiptianë përfaqësojnë dy komunitete të cilët vazhdojnë të përballen me përjashtimin social. Ndërsa mund të themi se komuniteti egjiptianë është disi më i integruar në jetën shoqërore komuniteti romë është në pozita më pak të favorshme se egjiptianët.

Aktualisht komuniteti romë përfaqëson komunitetin më të varfër dhe të marginalizuar etnik në Shqipëri. Papunësia masive e pas viteve 90' goditi romët, ata më shumë se çdo grup tjetër e gjetën veten të nxjerrë jashtë nga tregu i punës, duke e pasur të vështirë përfshirjen me kërkesat e tregut të ri të punës.

Familjet rome karakterizohen me shumë anëtarë, të cilët nuk kanë të ardhura dhe kanë humbur punën, nuk janë në gjendje të sigurojnë të paktën një jetesë modeste duke dhe nuk mund të përballojnë strehimin në banesa me kushte të pranueshme dhe pagesën e faturave të shërbimeve publike. Kjo çon në lëvizjen e tyre drejt vend strehimeve ku ata janë të detyruar të jetojnë në kushte jo të shëndetshme dhe që nuk kanë status legal.

Kështu që ata bëhen akoma dhe më të distancuar nga shërbimet publike, shkollat dhe mundësitë e punësimit. Situata e romëve nuk mund të thjeshtëzohet si një problem varfërie ose si çështje e një politike minoriteti. Në shqyrtimin e çështjes është e dukshme se në praktike konstatohen raste të përjashtimit dhe të vetë-përjashtimit si rezultat i rrethanave si ekonomike, sociologjike dhe psikologjike.

Karakteristikë tjetër për komunitetin rom është jeta jo e qëndrueshme e tyre në vendbanime të caktuara. Pasojat që sjell kjo lëvizje e herë pas hershme krijon probleme për këtë popullsi si dhe për vetë shtetin. Ndryshimi i ambientit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë tek tjetra, vështirësia për t'u ri-punësuar dhe integruar me jetën në një tjetër ambient, ka pasoja nga më të ndryshmet.

III - Analiza e studimit

Mbrojtja sociale

Fëmijët e komunitetit romë dhe egjiptianë përballen me një situatë të varfërisë por jo vetëm. Ato vuajnë përjashtimin social si shkak edhe i të ardhurave të ulëta të familjeve ku jetojnë. Niveli i ulët ekonomik i privon ato nga edukimi, kujdesi shëndetësor, përfshirja në jetën sociale etj. Kjo situatë i përball ato më punësimin në moshë të hershme, lypjen e kërkimit e mësimor duke qenë më të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe fenomeneve negative që vijnë si pasojë e kësaj.

Lidhur me nivelin e varfërisë mund të themi se komuniteti egjiptianë si dhe ai romë jetojnë në kushte varfërie dhe nevojat bazë të familjes dhe fëmijëve nuk plotësohen. Situata paraqitet më e rënduar për komunitetin romë ku kushtet e jetesës janë jashtëzakonisht të vështira.

Varfëria prek jo vetëm mirëqenien e fëmijëve në momentin kur mungojnë të mirat materiale dhe monetare, por ajo cënon edhe "mirë formimin e tyre". Ajo cënon rëndë kapacitetin për të evoluuar; vë në dyshim krijimin e potencialeve të nevojshme, si kapitalin e njohurive dhe dijeve, kapitalin kulturor, kapitalin social, kapitalin shëndetësor etj. Kjo pamjaftueshmëri e ndërtimit të "kapitalit human" rrezikon të çojë në atë që fëmija i varfër të bëhet një i rritur i varfër duke marrë shembull mënyrën e jetesës të prindërve të tij dhe komunitetit në përgjithësi.

Në Shqipëri, gjithashtu edhe në Tiranë ka shumë fëmijë të komunitetit rom të cilët jetojnë në rrugë. Kjo si pasojë detyrimit nga ana e familjes për të lypur ose për të pastruar makinat në kryqëzimet e Tiranës por në fund të ditës kthehen në shtëpinë e tyre. Ka fëmijë të cilët jetojnë

vetëm në rrugë të ndarë nga familjet e tyre. Ka edhe nga ato fëmijë të cilët jetojnë në rrugë me familjen pasi nuk kanë një shtëpi. Është bërë një debat i madh për këta fëmijë që të përfshihen në jetën sociale si bashkëmoshatarët e tyre duke i dërguar në shtëpitë e fëmijëve qoftë këto shtetërore apo private dhe dërgimin e tyre në shkollë. Dhe deri diku është arritur të ulet numri i këtyre fëmijëve. Por përsëri ka fëmijë të cilët jetojnë në rrugë sic u përmend më sipër me familjet e tyre dhe kjo kategori është edhe më e vështirë për t'i larguar nga rruga.

Në legjislacionin shqipëtar janë përfshirë një numër i madh aktorësh për trajtimin e rastit të fëmijëve të rrugës. Nuk ka një dakortësi për përkufizimin e këtij termi. Rruga është një pikë reference, jo domosdoshmërisht vendi ku fëmijët shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre.

Fëmijët e komunitetit romë dhe gjithashtu egjiptianë vuajnë përjashtimin social si pasojë e të jetuarit brenda familjeve të varfra. Padyshim ka një lidhje të fortë ndërmjet varfërisë dhe përjashtimit social. Përjashtimi social shkaktohet nga varfëria familjare dhe shoqërore si rezultat i mos pasjes mundësi të prekjes së të mirave dhe shërbimeve të mjaftueshme që e bëjnë fëmijën të jetojë në periferi të shoqërisë. Kjo i distancon ato nga mundësitë për arsim, të ardhura për punë, dhe nga aktivitete të rrjetit të komunitetit. Ata nuk janë të përfshirë në vendimmarrje dhe si rezultat i kësaj ato nuk janë në gjendje të ndikojnë mbi vendimet që prekin drejtpërdrejt interesat e tyre në jetën e përditshme.

Roli i OJF-ve

Padyshim që shoqëria civile ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut shumë të rëndësishëm në integrimin e fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë. Projektet e ndryshme që janë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatohen nga OJF-të ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale ofrojnë modele e praktika pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre komuniteteve. OJF të ndryshme, si: SoS - Fshatrat e Fëmijëve, World - Vision, Save the Children etj, që operojnë në qarkun - Tiranë kanë ofruar ekspertizën e tyre në disa drejtime. Ato kanë mundësuar ofrimin e shërbimeve edukative, shëndetësore, nxitje e arsimimit tek fëmijët e këtyre komuniteteve, reduktim të dhunës në familje, ofrim shërbimesh për një strehë të sigurt, shërbim psikologjik, fuqizim komuniteti me qëllimin e integritit të këtyre komuniteteve.

Përsa i përket përfshirjes së fëmijëve romë në sistemin e edukimit në shkollë, duke i larguar ato nga rruga, është bërë një punë e madhe qoftë nga pushteti lokal, ashtu edhe nga organizatat joqeveritare nëpërmjet fondeve të dhëna për blerjen e librave dhe regjistrimit të këtyre fëmijëve në shkollë si dhe për t'i përfshirë ata në jetën sociale si bashkëmoshatarët e tyre. Por jo gjithmonë kjo nisëm ka rezultuar e suksesshme pasi jo të gjithë fëmijët janë lejuar të shkojnë në shkollë, kjo për arsye të diskriminimit dhe për arsye ekonomike që janë detyruar nga prindërit të punojnë duke ia hequr mundësinë për tu shkolluar. Gjithsesi arsimi 9 vjecar është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët në republikën e Shqipërisë dhe largimin nga shkollë për çfarëdo arsye është i dënueshëm me ligj.

IV. Gjetje dhe konkluzione

- Ø **Komuniteti rom karakterizohet si “lëvizës”,** për rrjedhojë ky komunitet ruan më tepër vlerat/ traditat/ kulturën e vet dhe e ka më të vështirë procesin e integritit në jetën sociale. Ndërsa **komuniteti egjiptianë karakterizohet si më i qëndrueshëm,** për rrjedhojë ata e kanë më të vështirë të ruajnë traditat, vlerat e tyre duke u adaptuar më lehtë me vlerat e maxhorancës. Në këto kushte fëmijët e komunitetit egjiptianë janë më të integruar sesa fëmijët e komunitetit rom.
- Ø Në zonat/ lagjet/ fshatrat ku komuniteti rom jeton i përzier me maxhorancën, **procesi i integritit** është lehtësisht më i realizueshëm. Ndërsa në zonat ku komuniteti rom jeton i veçuar nga maxhoranca, është shumë i vështirë integrimi i tyre.
- Ø Një problem madhor i pjesëtarëve të komunitetit rom është mosrregjistrimi i tyre në gjendjen civile. Për arsye të ndryshme, mosrregjistrimi civil i prindërve dhe i fëmijëve të tyre, sjell përjashtimin nga shërbimet e mirëqënies sociale, si edhe të shërbimeve publike. Për rrjedhojë sipas ligjit nr, 9355 “Për Ndhmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, familjet e parregjistruara në gjendjen civile **nuk përfitojnë/ trajtohen nga skemat e Ndhmës Ekonomike.**
- Ø **Gjendja e vështirë ekonomike** i detyron prindërit e fëmijëve të komunitetit rom, që t’i shfrytëzojnë fëmijët e tyre si një mjet fitimprurës. Për rrjedhojë fëmijët lypin, shesin kanaçe, bajame, paketa etj duke u bërë pre e sjelljeve negative të shoqërisë.
- Ø **Në zonat ku jeton komuniteti rom,** sidomos në lagjet ku ata janë të veçuar nga maxhoranca **ka mungesa në kanalizimin e ujit të pijshëm.** UNDP nëpërmjet programit “Fuqizimi i komuniteteve vulnerabël në Shqipëri” ka bërë kanalizime në një pjesë të lagjeve ku jeton ky komunitet.
- Ø Në ciklet e ndryshme të sistemit arsimor (çerdhe, kopsht, arsimi i detyruar i ulët dhe i lartë, arsimi i mesëm) evidentohet një **shkallë e ulët e rregjistrimit në arsim** e fëmijëve të komunitetit rom.
- Ø Anëtarët e komunitetit rom nuk i kushtojnë një vëmendje të veçantë shërbimeve shëndetësore. Meqënëse një problem madhor i këtij komuniteti është mosrregjistrimi civil, është e **pamundur marrja e shërbimeve shëndetësore** të përshtatshme.

V.Rekomandime

- v Të evidentohet saktë gjendja e komunitetit romë dhe egjiptianë në qarkun - Tiranë dhe të ofrohen statistika mbi numrin e fëmijëve të këtyre komuniteteve; ndarja në grupmosha etj.
- v Raportet ekzistuese apo hartëzimi i vendndodhjes së komunitetit romë të vlerësohet sipas një frekuence për shkak të karakterit endacak (lëvizës) të këtij komuniteti.
- v Të mundësohet regjistrimi i anëtarëve të komunitetit romë dhe egjiptianë gjithashtu, të cilët aktualisht banojnë në territorin e qarkut - Tiranë.
- v Të rritet pjesëmarrja e fëmijëve romë e egjiptianë në sistemin arsimor parashkollor; të detyrueshëm dhe të mesëm;
- v Tu ofrohet strehim i përshtatshëm komunitetit romë.
- v Të përmissohen kushtet mjedisore dhe të infrastrukturës të banimit të këtyre komuniteteve me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme jetese e zhvillim miqësor për fëmijët.

- v Ngritja dhe vazhdueshmëria e projekteve për fuqizimin e familjeve të komunitetit romë dhe egjiptianë.
- v Ofrimi i formimit profesional dhe ndërmjetësim për punësim për komunitetet romë e egjiptianë si një mënyrë për ti integruar ato në jetën shoqërore dhe rritur statusin ekonomik të familjeve;
- v Shërbime edukative, orientuese, këshilluese për fëmijët romë egjiptianë e kryesisht ato që ndodhen jashtë arsimimit të cilët përballen me situatë rruge. Ngritja e shërbimeve adekuatë në profilin e qendrave sociale apo komunitare për këtë kategori.

BIBLIOGRAFI

1. Raport studimor “ Situata e fëmijëve romë në Shqipëri ” Unicef/Save the Children,2007
2. Raport i vecantë, Nr.4 “ Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit rom në Shqipëri ” Avokati i Popullit në Shqipëri, 2009.
3. Mapping Children Roma in Albania, CESS, Nentor 2012.
4. Studim “Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri në 2010”, UNICEF Shqipëri 2012.
5. Strategjia Kombëtare “Për përsimisimin e kushtetve të jetesës së minoritetit Rom”,OSCE, 2003
6. Adresa elektronike : www.sidalbania.org mbi hartëzimin digjital të komunitetit rom në Shqipëri, UNICEF/MPCSSHB
7. Raporti vjetor i Monitorimit të Zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, 2011-2012 ASHMDF.